Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/10
Datë: 06.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Rregullatorin e Energjisë.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/10
Datë: 06.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, duke vepruar së bashku si Administrator i Komisionit Evropian, për Projektin e Fondit të Kosovës për Efiçiencë të Energjisë.

2. Obligohet Ministria e Financave për ndërmarrjen e hapave, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/10
Datë: 06.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për Projektin e Ndërtimit të Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Prishtinë.

2. Obligohet Ministria e Financave për ndërmarrjen e hapave, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.